



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 39

Tiranë – E martë, 25 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Kuvendit nr. 8, datë 24.2.2025	Për delegimin e përfaqësimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve..... 3853
Dekret i Presidentit nr. 44, datë 20.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3853
Dekret i Presidentit nr. 45, datë 20.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3853
Dekret i Presidentit nr. 46, datë 20.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3854
Dekret i Presidentit nr. 47, datë 20.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3854
Dekret i Presidentit nr. 48, datë 20.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 3854
Dekret i Presidentit nr. 49, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3855
Dekret i Presidentit nr. 50, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3855
Dekret i Presidentit nr. 51, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3855
Dekret i Presidentit nr. 52, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3856
Dekret i Presidentit nr. 53, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3856

Dekret i Presidentit nr. 54, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3856
Dekret i Presidentit nr. 55, datë 20.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3856
Dekret i Presidentit nr. 56, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3857
Dekret i Presidentit nr. 57, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3857
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 10.2.2025	Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 302, datë 30.12.2024.....	3857

**URDHËR****Nr. 8, datë 24.2.2025****PËR DELEGIMIN E PËRFAQËSIMIT TË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PRANË KOMISIONERIT
SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE DHE
KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 76 të Kushtetutës, neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 7, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ:

1. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të Kuvendit pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

2. Përfaqësimi pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve bëhet nga vetë Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ose, rast pas rasti, nga punonjës të administratës së Kuvendit të përcaktuar në autorizimin e lëshuar prej Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

3. Sekretari i Përgjithshëm ose personi i autorizuar prej tij, sipas pikës 2 të këtij urdhri, autorizohet për përgatitjen e parashtimeve, pretendimeve përfundimtare, ankimeve, si dhe çdo veprim tjetër procedural të nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi në kuadër të përfaqësimit të Kuvendit pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Elisa Spiropali

DEKRET**Nr. 44, datë 20.2.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eduina Gazmend Kila
2. Charlotte Victoria Reynier Diaz
3. Françeska Robert Leskaj
4. Aron Florjan Pashaj
5. Emily Florjan Pashaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 45, datë 20.2.2025****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Brisilda Roland Kondi



2. Egla Ilirjan Hajno
3. Bjorna Astrit Kalaja
4. Alversa Gjergj Dragani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 46, datë 20.2.2025

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ederina Xhevair Malaj
2. Enis Fadil Kuleta
3. Asrin Fadil Malaj
4. Ergin Fadil Malaj
5. Eris Beqir Gelaj
6. Mara Eris Gelaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 47, datë 20.2.2025

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bora Dashamir Shahini
2. Azra Lulzim Rrashi
3. Ermira Shaip Koidl (Tahiri)
4. Adrian Astrit Rexhaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 48, datë 20.2.2025

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Juri Arben Hoxha
2. Etleva Naim Gjergji



3. Stela Edip Shiroka
4. Luna Gledis Hoxha
5. Lois Gledis Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 49, datë 20.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Dibran Bashkim Hoxhaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 50, datë 20.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr.

113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Agron Qazim Sokoli
2. Luan Ilaz Muja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 51, datë 20.2.2025

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Laureta Ilaz Muja
2. Drilon Asllan Nuza
3. Asllan Hasan Nuza

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 52, datë 20.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Aid Ramadan Hoxhaj
2. Lazime Nazim Rizanaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 53, datë 20.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mircan Metin Gökçen (Deveci)
2. Melisa Metin Deveci Alpaltun

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 54, datë 20.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Violeta Avdyl Memaj Koka
2. Valon Agron Bunjaku
3. Labinot Hivzi Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 55, datë 20.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Halil Bajram Cenaj
2. Yllka Bashkim Kusari
3. Bashkim Kadri Rakaj
4. Dorina Arben Doli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 56, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHETETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Christian Jalon Russell Massinburg

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 57, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHETETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dijar Blerim Ferati
2. Enis Škelzen Redžepi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 37, datë 10.2.2025

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT
TË ERE-s NR. 302, DATË 30.12.2024

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 44, dhe 144 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 483 prot., datë 28.1.2025, të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 302, datë 30.12.2024 ‘Mbi shqyrtimin e propozimit të FTL sh.a. për draftmarrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike



ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë”

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 302, datë 30.12.2024, vendosi: 1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës për shqyrtimin e draftit të “Marrëveshjes tip për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë” 2. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Marrëveshjes tip për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë”.

- Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. ka paraqitur një kërkesë nëpërmjet shkresës nr. 3731/2 prot., datë 6.1.2025, dhe shkresës nr. 3731/3 prot., datë 14.1.2025, duke kërkuar, fillimisht, informacion mbi dispozitivin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 302, datë 30.12.2024, dhe më pas, rishikimin e këtij vendimi dhe nisjen e procedurës për ndryshimin e Marrëveshjes Tip për Blerjen e Energjisë Elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike, sipas propozimeve të saj.

- Në bazë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 33, pika 1, germa “b” të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96/2016, shoqëria **FTL sh.a.** është aktualisht pjesë e një procesi shqyrtimi nga ERE dhe, për këtë arsye, legjitimohet si palë kërkuuese në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.

- Shoqëria FTL sh.a. ka përmbushur edhe kushtin e afatit 7 ditor për paraqitjen e kërkesës për rishikim, pasi ka marrë dijeni mbi vendimin nr. 302/2024 të mbledhjes së datës 30.12.2024, siç është referuar në shkresën e saj nr. 3731/2 prot., datë 6.1.2025, dhe ka paraqitur kërkesën për rishikim nëpërmjet shkresës nr. 3731/3 prot., datë 14.1.2025, në përputhje me nenin 104, pika 1, të “Kodit të Procedurave Administrative”.

- Shoqëria FTL sh.a., në kërkesën për rishikimin e vendimmarrjes së sipërcituar, ka provuar dhe argumentuar se; *reformulimi i nenit 4 të marrëveshjes është bërë për të përvaktuar qartë përgjegjësitë e Shitësit, në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë dhe legjislacionin në fuqi. Përvaktimi i qartë i afateve për dërgimin e parashikimeve dhe programeve të prodhimit është i nevojshëm për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të FTL sh.a., ndaj Operatorëve të Rrjetit dhe marrëdhënieve kontraktuale me aktorët e tjerë të tregut. Për më tepër, duke pasur parasysh se prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike mbulojnë kostot e disbalancave dhe nuk janë të detyruar të dërgojnë programe të sakta, FTL sh.a. vlerëson si të domosdoshme sigurimin e informacionit mbi disponueshmërinë teknike të impianteve prodhuese, në mënyrë që të përmirësojë parashikimet*

dhe të minimizojë gabimet, një praktikë e njohur gjerësisht në industrinë e energjisë.

- Për sa argumentuar, vlerësojmë se shoqëria FTL sh.a., ka provuar domosdoshmërinë e rishikimit të pikës 2 të vendimit nr. 302/2024, duke theksuar rëndësinë e: i) përcaktimit të qartë të afateve për dërgimin e parashikimeve dhe programeve të prodhimit; dhe ii) sigurimit të mekanizmave për përmirësimin e programeve të parashikimit dhe minimizimin e gabimeve nga ana e FTL sh.a. Këto problematika janë adresuar në nenin 4, pika 4.1, 4.2, 4.3, 4.3.1, 4.4, 4.4.1, 4.42, 4.5, përfshirë dhe klauzolat e parashikuara në nenin 5, dhe për këtë arsye është vlerësuar që vendimi të rishikohet për këtë pjesë.

- Në lidhje me pjesën tjetër të kërkesës së shoqërisë FTL sh.a., për rishikimin e vendimit nr. 302/2024, vlerësojmë se në shkresën e dërguar nuk janë paraqitur apo argumentuar prova të reja përveç atyre të parashtruara më herët, që mund të përbëjnë bazë për rishikimin e vendimmarrjes lidhur me fillimin e procedurave.

- Gjithashtu, është marrë në konsideratë se disa ndryshime në draft-marrëveshjen e propozuar përfshijnë përmirësime gjuhësore, saktësime të afateve dhe përditësime të bazës ligjore, të cilat nuk ndikojnë në thelbin e kontratës së miratuar më herët nga ERE. Për këtë arsye, këto ndryshime janë vlerësuar si të panevojshme për t’u përfshirë në procedurën për shqyrtimin e kontratës tip, objekt i vendimit nr. 302, datë 30.12.2024.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

- Duke marrë në konsideratë propozimet dhe argumentet e sipërpërmendura, si dhe duke garantuar transparencën dhe gjithë përfshirjen në vendimmarrje, vlerësojmë pranimin e e pjesshëm të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 302/2024 dhe përfshirjen në procesin e konsultimeve të këtyre ndryshimeve. Gjithashtu, këto ndryshime do të jenë pjesë e vendimmarrjes përfundimtare nga ana e ERE-s, pas përfundimit të procesit të konsultimeve publike me palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 302, datë 30.12.2024, ndryshohet/shtohet me paragrafët “ii” dhe “iii”, me përmbajtjen si më poshtë, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.



ii) Neni 4, me titull “Programet e livrimit dhe remontet”, pikat 4.1, 4.2, 4.3, 4.3.1, 4.3.2, 4.4, 4.4.1, 4.4.2; dhe pika 4.5, ku parashikohet si vijon:

4.1 Shitësi i vendos në dispozicion blerësit parashikimet dhe programet e prodhimit në terma afatgjatë dhe afatshkurtër dhe siguron blerësin që ato janë në përputhje me praktikatat më të mira të industrisë dhe legjislacionin e zbatueshëm.

4.2 Shitësi vendos në dispozicion të blerësit parashikimet dhe programet e prodhimit si më poshtë:

a) jo më vonë se data 1 (një) gusht e vitit aktual, parashikimin vjetor me bazë mujore të prodhimit të energjisë elektrike për vitin pasardhës;

b) jo më vonë se 1 javë para fillimit të secilit muaj, parashikimin mujor të prodhimit të energjisë elektrike;

c) jo më vonë se çdo ditë të mërkurë të secilës javë, për javën pasardhëse, parashikimin javor të energjisë elektrike;

Shitësi, për çdo ndryshim nga parashikimet e mësipërme, duhet të njoftojë blerësin në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe rregullat përkatëse.

4.3 Shitësi që ka përzgjedhur të jetë pjesë e grupit të balancimit duhet të deklarojë programin e prodhimit për çdo periudhë të shlyerjes së disbalancave, për ditën në avancë D-1...[...].

4.3.1 Shitësi, që nuk ka deklaruar programin e prodhimit në përputhje me pikën 4.3 të këtij neni, duhet të njoftojë blerësin jo më vonë se ora 09:00 AM të ditës paraprake D-1, për ditën D, lidhur me disponueshmërinë teknike (nëse ka kufizime) të impiantit prodhues, sipas aneksit, i cili është pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje, si dhe programin e remonteve apo ndërhyrjeve të tjera që mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë elektrike. Çdo ndryshim në disponueshmërinë teknike të impiantit prodhues duhet t'i njoftohet menjëherë blerësit.

4.3.2 Në rast se pjesëmarrësi i grupit të balancimit dështon në dërgimin e programit/skedulit të prodhimit të energjisë elektrike, atëherë parashikimi i programimit për pjesëmarrësin e grupit të balancimit do të bëhet nga lideri i balancimit të grupit të balancimit të Blerësit.

4.4 Shitësi, që ka përzgjedhur të mos jetë pjesë e grupit të balancimit të blerësit, duhet t'i deklarojë blerësit, brenda orës 09:00 AM të ditës D-1 për ditën D, programin e prodhimit për çdo periudhë shlyerjeje të disbalancave, bazuar në rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike.

4.4.1 Blerësi nuk do të pranojë asnjë program të ri apo të ndryshuar për ditën D, në D-1 dhe në D, qoftë një ditë më parë apo brenda së njëjtës ditë, nëse është deklaruar pas afatit të mësipërm. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm te ndonjë program i dërguar brenda afateve kohore të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë.

4.4.2 Në rast se shitësi nuk e deklaron programin e ditës në avancë blerësit, sipas përcaktimeve të pikës 4.4, atëherë programi që do të konsiderohet i nominuar dhe mbi të cilin operatori i sistemit të transmetimit do të përlogarisë disbalancat do të jetë (0) zero.

4.5 Shitësi i vendos në dispozicion blerësit programin e remonteve apo ndërhyrjeve të tjera, të miratuara nga operatorët e rrjetit, të cilat mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë elektrike.

iii) Neni 5, me titull “Shitja e energjisë elektrike në treg të lirë”, parashikohet si vijon:

5.1. Shitësi ka të drejtë të tregtojë të gjithë energjinë e prodhuar nga impianti gjenerues në tregun e lirë, me kusht që:

- Brenda datës 1 (një) gusht të vitit aktual, të informojë Blerësin se e gjithë energjia e prodhuar për vitin pasardhës do të tregtohet në tregun e lirë.

- Periudha minimale gjatë të cilës shitësi mund të shesë energjinë elektrike në tregun e lirë është 1 vit.

- Nuk do të jetë pjesë e grupit të balancimit të blerësit, për periudhën e tregutit në tregun e lirë.

5.2 Brenda datës 1 gusht të vitit në të cilin shitësi shet në treg të lirë, duhet të njoftojë blerësin për vijimësinë e shitjes në treg të lirë për vitin pasardhës. Në rast se shitësi nuk njofton për vijimësinë, konsiderohet që energjia e prodhuar prej tij do t'i shitet blerësit.

5.3 Tregtimi i energjisë elektrike të prodhuar nga impianti gjenerues në tregun e lirë, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk pezullon afatin e kësaj marrëveshjeje.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

